

KDU 323.233 (496.51) "1968" (091)
929 (496.51) Logja, Afrim

Prof. dr. Isa BICAJ

KONTRIBUTI I AFRIM LOXHËS NË DEMONSTRATAT E VITIT 1968

Kosova si njësi territoriale administrative e Federatës Jugosllave jo vetëm që ishte vendi më i pazhvilluar në Jugosllavi por edhe në Evropë. Kjo kishte krijuar pakënaqësi të popullata shqiptare e në veçanti të rinia dhe ajo studentore. Si rrjedhojë e kësaj pakënaqësie në vjeshtën e vitin 1968 shpërthyen demonstratat në disa qytete të Kosovës. Më masive ishte ajo në Prishtinë më 27 nëntor 1968. Ndër organizatorët e këtyre demonstratave ishte edhe Afrim Loxha.

Afrim Loxha u lind më 06. 08. 1946 në qytetin e Pejës.¹ Shkollën fillore e kreu në Pejë, kurse më 1961 familja e Afrimit u shpërngul në Prishtinë. Po këtë vit Afrimi u regjistrua në Shkollën e Mesme të Teknikës në Prishtinë në Drejtimin e Makinerisë ku e përfundon me sukses të shkëlqyeshëm. Gjatë shkollimit të mesëm Afrimi u njoh me shokë të rinj siç ishin: Osman Dumoshi, Skënder Muqolli, Ismet Ramadani etj., me të cilët do t'i lidhë fort jo vetëm angazhimi në procesin mësimor por edhe ideali kombëtar. Ashtu si Afrimi që rridhte nga një familje patriotike edhe Osman Dumoshi e Skënder Muqolli rridhnin nga familje të cilat përherë kishin qenë të angazhuara në çështjen kombëtare.

Kjo lidhje e Afrimit me Osman Dumoshin e Skënder Muqollin do të bëhet edhe më e fortë gjatë studimeve në Fakultetin Teknik.

Demonstratat e organizuara në Prizren, Therandë dhe në Pejë gjatë tetorit të vitit 1968 patën jehonë të madhe jo vetëm në Prishtinë por edhe në tërë Kosovën.

Si rrjedhojë në radhët e rinisë studentore në Prishtinë kishte filluar të shfaqej interesimi se diçka e tillë duhej të organizohej edhe në kryeqendrën e Kosovës në Prishtinë.

Afrimi është i burgosuri i parë nga organizatorët e demonstratave. Në deklaratat e dhëna para gjykatësit hetues më 29 nëntor 1968 dhe më 21 janar 1969 mund të konstatohet se Afrim Loxha bashkë me Osman Dumoshin e Skënder Muqollin janë ndër organizatorët kryesorë të organizimit të demonstratave të nëntorit të vitit 1968.²

1 Agjensioni Shtetëror i Arkivave (me tutje ASHA), nr. i fashikles 23/67, Gjykata e Qarkut- Prishtinë.

2 Po aty, Procesverbal me rastin e marrjes në pyetje nga gjykatësi hetues me 29. 11. 1968.

Sipas deklaratës dhënë në hetuesi idenë për organizimin e demonstratave e kishte dhënë Osman Dumoshi. Bisedat që ishin zhvilluar në mes të Osman Dumoshit, Afrim Loxhës dhe Skënder Muqollit ishin bërë në lokalet e Fakultetit Teknik, gjatë shëtitjes në korzo dhe në bufen e Shkollës së Lartë Pedagogjike. Gjatë takimeve që kishin pasur të lartpërmendurit ishte konstatuar se është e nevojshme që edhe në Prishtinë të bëhen demonstrata dhe në mënyrë të organizuar të shtrohen kërkesa për ndryshimin e gjendjes dhe avancimin kushtetues të Krahinës së Kosovës.³

Në këto rrethana në mbrëmjen e 16 nëntorit 1968 në shtëpinë e Osman Dumoshit është mbajtur takimi i parë ku veç të tjerëve ka marrë pjesë edhe Afrim Loxha. Ftesën për të marrë pjesë edhe Afrimi në takim e kishte marrë nga Osman Dumoshi. Takimi i mbajtur në shtëpinë e këtij të fundit ka filluar rreth orës 20:30 min. dhe ka zgjatur diku deri në orën 24:30 min. Në takim kanë marrë pjesë: Osman Dumoshi, Skënder Muqolli, Afrim Loxha, Selatin Novosella, Adil dhe Ilaz Pireva, Xheladin Rekalii dhe më vonë kanë ardhë edhe rrobaqepësit Tefik Qitaku dhe Ramadan Rrahmani.⁴

Në këtë takim Afrimi ka paraqitur mendimin e vet lidhur me organizimin e demonstratave. Veç tjerash Afrimi ka propozuar që demonstruesit të tubohen në hapësirën pas Fakultetit Filozofik dhe pjesëmarrësit të vinë nga tri drejtime: nga Vranjevci, nga Shkolla Normale dhe nga Shkolla Bujqësore. Mirëpo, ky propozim i Afrimit nuk është aprovuar nga shumica e pjesëmarrësve dhe është vendos që pjesëmarrësit t'i bashkëngjiten në mënyrë spontane ashtu siç atyre do t'u dukej më e lehtë.⁵

Në takim është debatuar lidhur me caktimin e ditës së mbajtjes së demonstratave ku janë shfaqur mendime të ndryshme. P.sh Adil dhe Ilaz Pireva kanë propozuar që demonstratat të mbahen ditën e martë më 26. 11 sepse ajo është ditë pazari në Prishtinë dhe ka mundësi që pjesëmarrja e demonstruesve të jetë më e madhe. Ndërsa, Afrim Loxha ka propozuar që data të jetë 27.11, sepse kjo është datë e vigjiljes së shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe kjo do të mundësonte pjesëmarrjen më të madhe të njerëzve në demonstrata.⁶

Në këtë takim është debatuar për mënyrën e organizimit dhe formën e punës që duhet bërë rreth bindjes së njerëzve për të marrë pjesë në demonstrata. Çdo njëri nga pjesëmarrësit u obliguan që të bisedonin me të afërmit dhe shokët për nevojën e organizimit të demonstratave dhe sqarimin e arsytetshmërisë së mbajtjes së këtyre demonstratave. Po ashtu, është marrë qëndrim që gjatë bisedave, njerëzve duhet t'u sqarohet që kërkesat e demonstruesve të jenë: Kushtetutë, Republikë, Vetëvendosje

3 Po aty, f. 1.

4 Po aty.

5 Po aty.

6 Po aty, f. 3.

dhe përmirësimi i strukturës së punësimit në favor të popullit shqiptar. Në këtë takim është marrë qëndrim që demonstruesit mos të brohorasin parulla për Shqipërinë dhe udhëheqësit e atëhershëm të shtetit shqiptar. Është me rëndësi të ceket se në këtë takim Afrim Loxha ka kërkuar që demonstruesit të brohorasin parullën “Të ndërpritet gjakderdhja midis shqiptarëve”, sepse ishte i vetëdijshëm se kjo ishte plagë e madhe që e kishte rënduar seriozisht jetën e shumë familjeve shqiptare.⁷

Afrimi deri në takimin e dytë kishte kontaktuar me shumë individë dhe kishte biseduar për arsyetushmërinë e organizimit të këtyre demonstratave. Ndër ta ishin studentët e Fakultetit Teknik, Sylejman Preposhi, Ahmet Jashanica etj. Me njerëzit që kishte biseduar Afrimi ishin pajtuar me mendimin e tij dhe i kishin premtuar këtij të fundit se do të bisedonin edhe me njerëz të tjerë për të marrë pjesë në demonstrata.⁸

Në kohën midis dy takimeve Afrimi ishte takuar me Adil Pirevën dhe Hasan Dermakun dhe kishte biseduar lidhur me angazhimin dhe punën që po bëhej rreth bindjes së njerëzve për pjesëmarrje në demonstrata. Vlen të ceket se Hasan Dermaku ishte shumë optimist dhe ishte thellësisht i bindur se demonstratat do të jenë masive dhe do të përkrahen nga rinia studentore dhe qytetarët. Afrimi gjatë kësaj kohe ka bërë përpjekje që të bie në kontakt me shokun e tij nga Ferizaji Ismet Ramadanin në mënyrë që ai të organizojë njerëz nga qyteti i Ferizajit që të vinë në Prishtinë për të marrë pjesë në demonstrata. Këtë porosi Afrimi ia kishte qar Ismetit nëpërmes Ibrahim Sylejmanit.

Në takimin e dytë që është mbajtur në shtëpinë e Selatin Novosellës më 23. 11. 1968 kanë marrë pjesë Osman Dumoshi, Selatin Novosella, Adil dhe Ilaz Pireva, Skender Muqolli, Hasan Demaku, Xheladin Rekalii dhe Afrim Loxha. Pjesëmarrësit e takimit kanë marrë qëndrimin unanim që demonstratat duhet të mbahen më 27 nëntor në orën 15:55 min. dhe kolona më transparente në dorë duhet të niset nga hapësira pas Fakultetit Filozofik. Po ashtu, në këtë takim të gjithë pjesëmarrësit informuan për angazhimin e tyre dhe bisedat që kanë bërë ata me njerëz lidhur me pjesëmarrjen në demonstrata. Sipas informacioneve të dhëna pjesëmarrësit konstatuan se numri i demonstruesve mund të arrijë deri në 300. Në informacionin që e dha Afrim Loxha në këtë takim deklaroi se ai kishte biseduar dhe kishte bindur 21 persona që ishin të sigurt për të marrë pjesë në këto demonstrata. Po ashtu, Afrimi deklaroi se gjatë vikendit do të shkonte në vendlindjen e tij në Pejë për të biseduar edhe me njerëzit e tjerë të afërm e miq për t'i bindur ata që ditën e demonstratave të vinë në Prishtinë.⁹

7 Po aty.

8 Po aty, f. 4.

9 Po aty, f. 6.

Në takimin e lartpërmendur të gjithë pjesëmarrësit kishin marrë detyrat dhe obligimet që duhet t'i kryenin gjatë demonstratave. Afrimi kishte obligim që të jetë në krye të kolonës së demonstruesve dhe t'u printe atyre deri te Teatri Kombëtar. Ndërsa, gjatë leximit të fjalës që do të mbahej në kulmin e "Optikës" Afrimit bashkë me Skender Muqollin ju caktua detyra që të mbanin rendin dhe të pengonin ndërhyrjen eventuale të policisë për kapjen e personit që do të mbante fjalën e rastit.

Siç del nga procesverbalet e hetuesisë Afrim Loxha të gjitha obligimet që i kishte marrë si në takimin e parë ashtu edhe në të dytin i ka kryer me përgjegjësi të plotë.¹⁰

Afrimi gjatë tërë kohës së hetuesisë ka mbajtur një qëndrim dinjitoz dhe për asnjë moment nuk është përdorur për veprimet dhe detyrat që i ka kryer në organizimin dhe udhëheqjen e këtyre demonstratave. Në pyetjen kur gjykatësi hetues i bën pëse demonstruesit bënë shkatërrime (thyerje të xhamave të vitrinave, përmbysje të veturave etj), Afrimi iu përgjigj: "Po mos të ishte përdorë dhuna nga ana e policisë e cila shkaktoi revoltë, natyrisht se demonstruesit nuk do t'i kryenin këto veprime".¹¹ Po ashtu, në pyetjen tjetër që ia kishte bërë gjykatësi hetues se kush qëndron pas jush në organizimin e këtyre demonstratave, Afrimi përgjigjet: "Edhe dje dëgjova lajmet se organizimi i demonstratave është bërë nga jashtë. Unë e them me plot kompetencë e përgjegjësi deklaron Afrimi se pas nesh nuk ekziston asnjë organizatë, asnjë komitet dhe asnjë këshill. Unë e thash edhe më parë se organizatorët e demonstratave jemi ne dhe askush tjetër".¹²

Organizatorët e demonstratave të vitit 1968 edhe pse relativisht në moshë të re kanë treguar një pjekuri të lartë politike si gjatë hetuesisë ashtu edhe gjatë gjyqimit. Këta për asnjë çast nuk shfaqën pendesë dhe ajo që është më madhore është qëndrimi dinjitoz dhe vendosmëria e tyre për të drejtën e organizimit të këtyre demonstratave. Vlen të ceket se organizatorët e këtyre demonstratave gjatë ballafaqimit me njëri tjetrin para gjykatësit hetues kanë treguar pjekuri të lartë politike. Kështu, p.sh. Osman Dumoshi, Selatin Novosella dhe Skënder Muqolli në ballafaqim me Afrim Loxhën jo vetëm që nuk e rënduan Afrimin për angazhimin e tij në demonstrata por përkundrazi të tretë morën mbi vete përgjegjësinë se ata kishin përgatitur dhe organizuar demonstratat.¹³ Në këtë rast Afrim Loxha me një vendosmëri të jashtëzakonshme deklaroi se gjithçka që kemi punuar e kemi bërë bashkërisht dhe përgjegjësitë për të gjitha këto veprime janë të përbashkëta. Më 7 prill 1969 në Prishtinë u mbajt gjykimi nën

10 Po aty.

11 Po aty, f. 7.

12 Po aty.

13 Po aty.

kryesinë e Nazmi Junikut dhe Afrim Loxha u dënua me 3 vite burgim.¹⁴ Mirëpo, në ankesën e bërë nga mbrojtja, Gjyqi Suprem i Kosovës i kryesuar nga Ramadan Vraniqi uli dënimet për të gjithë organizatorët e demonstratave nga një vit.¹⁵ Kështu Afrimi si njëri ndër organizatorët e këtyre demonstratave mbajti dy vite burgim të rëndë. Pjesën më të madhe të kohës së dënimit e ka mbajtur në burgun e Nishit.

Pas mbajtjes së dënimit Afrim Loxha vazhdoi studimet dhe pas përfundimit të studimeve punoi si inxhinier në Ndërmarrjen Ekonomike Elektrokosova në Obiliq. Gjatë tërë kohës së tij është angazhuar në përgatitje e kuadrit të ri dhe në të njëjtën kohë është angazhuar në ndryshimin e strukturës etnike të kuadrit sepse deri në shkuarjen e tij si inxhinier në këtë gjigant ekonomik shumica e drejtuesve të repartëve ishin të përkatësisë serbe. Si rrjedhojë e kësaj veprimtarie të guximshme Afrim Loxha në vazhdimësi ishte në vrojtim të organeve të shërbimit sekret jugosllav.

Afrimi ka qenë aktiv edhe në vitet 90-ta të shekullit të kaluar. Me shpërthimin e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Afrimi ka qenë aktiv në mbledhjen e ndihmave materiale. E cekem edhe më lart se Afrimi ishte nën përcjellje të organeve të pushtetit serb. Si rrjedhojë pas fillimit të bombardimeve të NATO-së deri sa po shkonte për pune personale në një lokal të Dardanisë afër postës vritet në mënyrë mizore nga forcat paramilitare serbe. Dhe kjo nuk ishte rastësi, por ishte e planifikuar mirë nga organet policore serbe.

¹⁴ Po aty, Procesverbal me rastin e gjykimit të Afrim Loxhes më 7, prill 1969.

¹⁵ Po aty, Procesverbal i Gjyqit Suprem i udhëhequr nga Ramadan Vraniqi, ju fal nga një vit burg.

Prof. dr. Isa BICAJ

SUMMARY

**THE CONTRIBUTION OF AFRIM LOXHA IN 1968
DEMONSTRATIONS**

Afrim Loxha one of the organizers and the main leader of demonstrations of 1968. was arrested in 29 December 1968. During the interrogation Afrim maintained very principals of resistance without hesitation and declared in front of the Court he participated in two meetings held in the house of Osman Dumoshi and Selatin Novosella regarding the organization of demonstrations and the demands derived there.

He got sentenced to three years in prison for his "hostile activity", while the Supreme Court appeal pardoned a year of sentence. After completing a two-year sentence, Loxha graduated his studies and got employment with Elektrokosova. As engineer he gave a valuable contribution in preparation, education and practical engagement of new personnel.

Loxha has been actively involved all the time in the national domain. He was under constant surveillance by internal affairs agencies. As a result of this patriotic activity, Afrim was killed on April 1, 1999 by the Serbian paramilitary forces close to where he lived in Dardania, following the international bombardments in Serbia.